

“Njerëzit duhet të jenë punëtorë dhe krijues”!



Shën Porfiri na këshillon:

Njerëzit duhet të jenë punëtorë dhe krijues. Insistonte, sidomos, për të rinjtë, që të mos rrinë pa punë, indiferentë, të mos jenë të plogët e të pakujdesshëm.

Njerëzit të lëvizin, t'i përdorin të gjitha gjymtyrët e trupit të tyre, të mos jenë dembelë.

Nuk bëhet dikush i krishterë me dembelizmin; duhet punë, shumë punë.

Vetë shenjtori ishte punëtor dhe nga ana fizike, dhe nga ana shpirtërore, dhe në punë i nxiste njerëzit, sepse papunësia, dembelizmi, plogështia janë rrënja e shumë sëmundjeve trupore dhe shpirtërore.

Duhet shumë vjet të mbarosh një shkollë të lartë. Por sa më shumë vjet duhet për ta kuptuar dhe zbatuar dëshirën e Perëndisë, ndaj nevojitet punë, shumë punë fizike dhe shpirtërore.



— facebook.com/MitropoliaFier